



Home > Aktualitet > Arrestohen dy persona, u sekuestrohen 3 armë dhe municion luftarak. Kishin m...

AKTUALITET

Arrestohen dy persona, u sekuestrohen 3 armë dhe municion luftarak. Kishin mbjellë dhe 60 rrënjë kanabis

Sipas një njoftimi për mediat bëhet me dije se janë sekuestruar disa armë dhe municione të tjera luftarake, armë gjahu, armë të e të ftohta e dylbi.



21 Gusht, 2019 12:40

TIRANË- Dy persona kanë përfunduar në pranga, 60 bimë kanabis janë asgjësuar ky është bilanci i një operacioni të Policisë së Tiranës.

Sipas një njoftimi për mediat bëhet me dije se janë sekuestruar disa armë dhe municione të tjera luftarake, armë gjahu, armë të e të ftohta e dylbi.

“Si rezultat i të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit: L. B., 33 vjeç, banues në Zall-Bastar, Tiranë; P. N., 58 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë”, shkruan ndër të tjera Policia.

NJOFTIMI I PLOTË

Finalizohet operacioni “Bulceshi”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e kultivimit të bimëve narkotike. Operacioni nga Komisariati i Policisë Nr. 4 Tiranë.

Sekuestrohen 3 armë zjarri, një armë e ftohtë, municion luftarak, si dhe asgjësohen 60 bimë kanabis. Në pranga dy shtetas, si autorë të dyshuar të kultivimit të kanabisit dhe armëmbatjes pa leje.

Për më shumë bëhu pjesë e grupit më viral në Facebook, [Dosja.al](#)

Në kuadër të operacionit masiv për kontrollin e territorit, me qëllim parandalimin, evidentimin dhe goditjen e rasteve të kultivimit të bimëve narkotike, nga shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 4, është finalizuar operacioni policor “Bulceshi”, si rezultat i të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit: L. B., 33 vjeç, banues në Zall-Bastar, Tiranë; P. N., 58 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë;

Gjatë kontrollit të territorit dhe mbi bazën e informacioneve të grumbulluara më parë, shërbimet e Policisë, në vendin e quajtur Bulcesh, Njësia Administrative Zall-Bastar, në një zonë malore dhe me bimësi të dendur, u gjetën të kultivuara dhe u asgjësuan 60 bimë, të dyshuara si bimë narkotike të llojit Cannabis Sativa.

Gjithashtu, gjatë kontrollit policia gjeti dhe sekuestroi një armë zjarri pistoletë, dy armë gjahu çifte, një armë të ftohtë thikë, një palë dylbi dhe një sasi municioni. Vijnë puna për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal.

Materialet iu referuan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për veprat penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake e municionit” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta”.

(A.B. Dosja.al)

DR LIGHT

ETIKETA: #Arrestohet 2 persona ne Tirane #operacioni bulceshi #sekuestrohen arme

5

SHARES



Previous article

Çfarë do ndodh me dosjen 184? Krimet e Rënda shpallin moskompetencë

Next article

“S’e them për p*rdhë”, Tërmet Peçi përgënjeshtrohet e sulmon mediat, por ngatërrohet sërisht (VD)